



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	19.02.2025
Nr. 1136	Prot.

Lënda: Kërkojmë shtesë fondesh buxhetore për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në funksion të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025, në buxhetin e vitit 2025

MINISTRISË SË FINANCAVE

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon disa shtesa në buxhetin e këtij institucioni.

Lutem gjeni në vijim vlerat dhe shpjegimet përkatëse për këto shtesa:

1. Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, parashikohet që shpenzimet për dërgimin dhe kthimin e fletës së votimit dhe çdo materiali tjetër zgjedhor dhe informativ nga KQZ tek votuesit nga jashtë, paguhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
Të dhënat e deritanishme mbi regjistrimin e votuesve nga jashtë tregojnë për një numër të lartë të tyre. Vlerësohet se ky numër do të jetë midis 200 – 250 mijë votues nga jashtë.
KQZ në buxhetin e miratuar për zgjedhjet 2025 për shërbimin postar të votuesve nga jashtë ka miratuar fondet buxhetore vetëm për 100,000 votues në shumën 500,000,000 lekë.
Për votuesit mbi këtë numër KQZ ka përgatitur dy skenarë (5 mijë lekë/votues shërbim postar)
 - a. Skenari nr.1: projeksioni i rritjes me 150,000 votues nga jashtë vendit kërkon mbështetje me fonde buxhetore shtesë në shumën 750,000,000 lekë.
Skenari nr.2: projeksioni i rritjes me 100,000 votues nga jashtë vendit kërkon mbështetje me fonde buxhetore shtesë në shumën 500,000,000 lekë.
 - b. Në funksion të realizimit me sukses të procesit të votimit nga jashtë parashikohen shërbime për sistemet TIK të monitorimit/ ruajtjes dhe sigurisë fizike të vendit të përgatitjes së bazës materiale si dhe në ambientet për numërimin dhe ruajtjen e votave, shpenzime infrastrukture dhe bazë materiale.
Fondet e nevojshme për këto shërbime përllogariten në shumën 26,300,000 lekë.
 - c. Rritja e numrit të votuese me jashtë detyrimisht shoqërohet dhe me ndryshime të bazës materiale të nevojshme si kuti votimi, proces verbale, zarfa etj.
Fondet e nevojshme për këto materiale përllogariten në shumën rreth 6,100,000 lekë.
 - d. Fushata informuese për zgjedhjet e 11 Majit 2025, për votimin nga jashtë për shkak të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të datës 17.02.2025, pëson ndryshime duke nisur nga prodhimi i spoteve, tutorialeve, fushata online, si dhe fushata outdoor e KQZ-së.
Fondet e nevojshme shtesë për fushatën informuese janë në shumën 30,000,000 lekë.



- e. Për realizimin e proceseve të a) përgatitjes së dokumentacionit zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë vendit, b) dërgimi i dokumentacionit zgjedhor të zgjedhësit, c) dërgimi i dokumentacionit zgjedhor në KQZ nga zgjedhësi, d) ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit zgjedhor të dërguar nga zgjedhësi nga momenti i mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në fillimin e numërimit dhe të vlerësimit të votave nga jashtë vendit, paraqitet domosdoshmëri punësimi i 80 punonjësve me kohë jo të plotë pune, për një afat 3 mujor.

Fondet e nevojshme për punonjësit e përkohshëm për paga dhe sigurime janë në shumën 28,000,000 lekë.

- 2- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 paraqiti kërkesën për investime për blerjen e 4.259 “Pajisje elektronike për votimin dhe numërimin PEVN” në shumën 2.3 miliardë lekë, duke përfshirë në këtë vlerë edhe shërbimin e suportit. E gjitha kjo për zhvillimin e Votimit dhe Numërimit Elektronik në pesë qarqe. Në ligjin 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, nuk u miratuan fonde për implementimin e zgjerimit të Votimit Elektronik në 5 qarqe. Në këto kushte KQZ duhet të përmbushë vetëm detyrimin ligjor për zhvillimin pilot të Votimit dhe Numërimit Elektronik, për vetëm 402 qendra votimit.

Zhvillimi i këtij procesi implikon shërbime për transmetimin e të dhënave, shërbimet të përgatitjes së pajisjeve të cilat mundësojnë integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e sistemit, suportin teknik të terrenit, etj.

Fondet e nevojshme shtesë për këto shërbime janë në shumën 87,000,000 lekë.

- 3- Në buxhetin e vitit 2024 në programin “Planifikim, menaxhim, administrim” u miratua projekti “Rikonstruksion i sallës së serverave dhe rrjetit network të KQZ, dysheme teknologjike dhe sistem kondicionimi” në shumën 22,000,000 lekë në vitin 2024. Ky investim u realizua 44% gjatë vitit 2024 dhe për shkak të afatit të realizimit kontrata përfundon në muajin e parë të vitit 2025.

Për realizimin e plotë të kontratës fondi i nevojshëm është në shumën 10,550,000 lekë.

Në mënyrë të përmblodhur kërkesat për fonde shtesë në buxhetin e vitit 2025 për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë në shumën 937,950,000 lekë dhe paraqiten si në tabelën bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
A.Kota
E.Topulli
A.Lamçe
M. Çelmeta



Tabela nr.1**Kërkesat për fonde shtesë në buxhtin e vitit 2025 të KQZ-së në funksion të zgjedhjeve 2025*****Lekë***

		Programi "Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore"- 01620	Kërkesa shtesë Buxheti 2025
1	a	Shërbime të postimit dhe kthimin të fletës së votimit të votuesve me jashtë	750,000,000
	b	Shërbime të sisteme TIK të monitorimit të ruajtjes fizike dhe vendit të përgatitjes së bazës materiale si dhe ambientet e numërimit dhe ruajtjen e votave, shpenzime infrastrukture dhe bazë materiale për krijimin e kushteve të punës	26,300,000
	c	Bazë materiale Kuti votimi, proces verbale, zarfa shtypshkrime, kancelari etj	6,100,000
	d	Fushata informuese për zgjedhjet e 11 maji 2025	30,000,000
	e	Paga Sigurime shoqërore shëndetësore punonjës të përkohshëm	28,000,000
2	-	Shërbime të suportit dhe përditësime për Votimin Elektronik për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025	87,000,000
		<i>programi 01620</i>	927,400,000
		Programi "Planifikim, menaxhim, administrim"- 01610	
3	-	Rikonstruksion i sallës së serverave dhe rrjetit network të KQZ, dyshe me teknologjike dhe sistem kondicionimi	10,550,000
		<i>programi 01610</i>	10,550,000
		Total i fondeve shtesë KQZ	937,950,000